

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ prot.

Vlorë, më ____ . ____ .2026

PROCES VERBAL-Tipi i kontratës – e hapur e thjeshtuar Pune

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE
TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është përefekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti : “ Rikonstruksion i nyjes hidraulike ne kanalin e Naumkes, ne segmentin e kalimit te rruges dhe linjes hekurudhore, ne funksion te permireshimit te kullimit dhe shkarkimit drejt Hidrovorit

Fondi Limit: 9,150,046.⁵⁹ (nentemilion e njeqind e pesedhjetemije e katerqind e dyzet e gjashte pike pesedhejte e nente) **Leke pa TVSH**

Objekti : “ Rikonstruksion i nyjes hidraulike ne kanalin e Naumkes, ne segmentin e kalimit te rruges dhe linjes hekurudhore, ne funksion te permireshimit te kullimit dhe shkarkimit drejt Hidrovorit

REF-96222-08-13-2026

Kodi CPV: 45210000-2 - Punime ndërtimi

E hapur , e thjeshtuar Pune

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi CPV: 45210000-2 - Punime ndërtimi

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 12 muaj

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1.Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës sipas DST;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës sipas DST;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26 dhe 29 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

2.Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (regjistrat tregtarë, sipas nenit 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së) dhe të kete në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin **vërtetim për xhiros vjetore për** vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomik arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor

është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ky kriter kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për keestet e maturuara të vitit 2026 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar).

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se).

Kjo kërkesë është vendosur me qëllim që AK të ketë mundësinë të shohë nëse OE pjesmarrës kanë apo jo detyrime ndaj NJ.Q.V, fakt që tregon fleksibilitetin e tyre financiar.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, nën 4, pika 2 d).

Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2026 sipas kësaj, prandaj bashkëve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.2.3 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore të 3 (tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të çertifikuara nga organet tatimore si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.(i

ndryshuar). Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 *”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar”* i ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.3 Kapaciteti teknik: Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet , të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është në një vlerë jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Shënim: (*Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi*).

2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktura dhe Energji, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme në ndërtim :

- Kategoria NP-1 “Punime germimi ne toke”. **EKUIVALENTE**
- Kategoria NP-4 “Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale” **EKUIVALENTE**
- Kategoria NP-7 “ Ujesjelles kanalizime,vepra kullimi vaditje,Ndertim konstruksioni ujesjellese,rrjete kanalaizimi te ujrave te bardha dhe te zeza, vepra hidraulike te ngjashme . **EKUIVALENTE**

Operatorët ekonomikë duhet të kenë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë ata duhet të paraqesin licencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencave profesionale për zbatimin, klasifikimin dhe disiplinimin e personave juridikë që ushtrojnë veprimtari ndërtimore".

NP-1: Punime germimi në tokë

Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

NP-4 Rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha. Linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet nën nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tramvaji, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrore dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderur, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi "goma", "hekur", "zona", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo vepre lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.

NP-7 Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të pijshëm, ujësjiellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse		
NP-1	Punime gjërmimi në tokë	- Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet -		
NP-4	Rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha. Linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale	- Shtrese stabilizant t=15cm - Cilindrim kasonete me rul - Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri - Shtrese stabilizant t=15cm - Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri - Shtrese binderi me granil gur kave,6cm,me makineri - Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri		
NP-7	Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje	- Punime te ujsjellsit dhe kanalizimet		

Argumentimi :

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit Nr. 8 402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, ku neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj të pajisur me licencën përkatëse për zbatim punimesh ndërtimi. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e

materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomikë të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko – profesionale në nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

2.3.3. Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt sipas Neni **nenit 8 , pika 2 te VKM-se Nr.448 date 31.7.2025** , i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Bashkelidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe b) Diploma.

Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt se ai është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë persiper sipas përqindjes së bashkepunimit.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: *Së pari*, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”. *Së dyti*, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë që ka të bëjë me Funizim Vendorsje sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr.2, datë 13.05.2005 “ Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papaftueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të

drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paafësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga rendësia e objektit të kontratës, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dipsozitive ligjore në fuqi.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë ofertuese, si më poshtë:

Inxhinier Ndertimi 1 (nje)

Inxhinier Hidroteknik 1(një)

- Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për te pakten 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Për inxhinierët duhet të paraqiten:Diploma, Kontratë individuale pune (e vlefshme),librezë pune, C.V.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinier Ndertimi** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe kategorisë së kërkuar në licencën profesionale të shoqërisë.

- **Inginier Hidroteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe kategorisë së kërkuar në licencën profesionale të shoqërisë.

. Kriteri i mësipërm ne lidhje me stafin kryesor është lidhur edhe me disponueshmërinë e licencës dhe kriterëve të licencës së kërkuar. Konkretisht në Vendimin 42, date 16.01.2008 i Këshillit të Ministrave “Per miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies se licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar parashikohet se: “Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas: I. Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në: - profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë.”

Sa më sipër, duke marrë parasysh natyrën e punëve të objektit të prokurimit, ka përzgjedhur stafin e drejtuesve teknik, të cilët janë të nevojshëm për realizimin e punimeve duke u bazuar në natyrën e kësaj pune.

2.3.5 Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe staf (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- 1 (një) punonjës të certifikuar me dëshmi trajnimi si “*Person i ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë*” të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, kërkesë kjo në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.10237 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.
-

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të ketë fuqi minimale punetore të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, me një numër prej mesatarisht 43 (dyzet e tre) personave, 3 (tre) muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për të paktën tre muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.
- Listepagesat e deklaruara në organet tatimore bazuar në vkm nr. 514 datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve” për të paktën tre muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Argumentimi :

Gjithashtu për të vërtetuar zoterimin e fuqisë punetore si dhe stabilitetin e saj është duke kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe në listepagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr 285, datë 19.05.2021 *Per miratimin e rregullave të prokurimit publik dhe sipas të ciles: Autoriteti/enti kontraktor , pervec kerkesave te parashikuara ne kete nen, mund te percaktojë kriteret e tjera te vecanta, ne varesi te objektit qe prokurohet, te cilat i vlereson te nnevojshme per ekzekutimin me sukses te kontrates.*

Shenim:Ne momentin e vleresimit dhe shqyrtimit te kriterve klasifikuese ky kriter do te konsiderohet i permbushur me dorezimin e vetdeklarimit permbledhes sipas Shtojces 8, bazuar ne nenin 82 te Ligjit Nr. 162/2020 Per prokurimin publik si dhe ne germenin dh) te pikes 2 te nenit 26 te Vendimit nr.285 date 19.05.2021 te Keshillit te Ministrave Per miratimin e rregullave te prokurimit publik, i ndryshuar

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar / të kualifikuar, si dhe të përfshirë në listepagese për të paktën tre muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit., me profesionet si mëposhtë:

- 1 (një) specialist ndertimi
- 2 (dy) teknik Kantieri

- 1 (nje) topograf
- 5 (pese) betonues
- 2 (dy) hidraulike
- 8(tete) karpentier
- 6 (gjashte) Hekurthyes
 - 9 (nente) punetore te ndryshem
 - 2 (dy) manovrator
 - 4 (kater) shofer

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune të vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Shënim: Për shoferët,eskavatoristet,manovratore Operatori Ekonomik pjesëmarrës mund t'i disponojë edhe të kontraktuar me kontratë pune / shërbimi për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Argumentimi : Kërkesat e mësipërme janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

1. MOBILIZIMI FILLESTAR (JAVA 1–2)

Zbatimi nis me një ekip prej 18 personash, i përqendruar te instalimi i kantierit, sinjalistika, gardhimi perimetrik dhe çmontimi i sipërstrukturës hekurudhore. Në këtë fazë përbërësi kryesor është ekipi hekurudhor (4 punëtorë të specializuar) i shoqëruar nga inxhinieri hekurudhor dhe topografi për rilevimin e gjurmës para çmontimit.

Në javën 2 fuqia rritet në 23 persona për shkak të mbivendosjes së çmontimit me fillimin e gërmimeve. Mobilizohen dy operatorë eskavatori, operatori i rulit dhe rritet numri i shoferëve për largimin e dherave (rreth 429 m³ gërmim gjithsej). Njëkohësisht nis përgatitja e armaturës në kantier me 2 hekurkthyes, në mënyrë që kafazet të jenë gati para derdhjes së parë.

2. RITJAE INTENSITETIT (JAVA 3–4)

Java 3 shënon kalimin nga punimet e tokës në punimet strukturore: 29 persona, me hyrjen e plotë të zejeve të specializuara — 4 karpentierë, 4 hekurkthyes dhe 3 betonistë për shtresën e çakëllit, betonin e pastrimit C12/15 dhe pllakën e poshtme.

Në javën 4 fuqia arrin 35 persona. Ekipi i kallëpeve rritet në 7 karpentierë dhe armaturistët në 6, sepse në këtë javë ndërtohen njëkohësisht muret anësore, muri ndarës dhe përgatitet pllaka e sipërme e dy kutive BOX. Vlerësimi bazohet në sipërfaqen totale të kallëpeve dhe në normën ~12 m² kallëp/ditë/karpentier.

3. PIKU I FUQISË PUNËTORE (JAVA 5)

Java 5 është pika maksimale e mobilizimit me 43 punonjës. Kjo javë përkon me mbivendosjen e tre proceseve kritike të Grafikut Gantt: përfundimin e strukturës së kutive BOX (pllaka e sipërme dhe hidroizolimi), fillimin e mureve hyrëse dhe dalëse, dhe përgatitjen e sistemeve mbrojtëse me gurë e gjeotekstil.

Përbërja në pik: 8 karpentierë, 6 armaturistë dhe 5 betonistë (19 zejtarë të specializuar), 8 operatorë e shoferë, 8 punonjës drejtues/teknikë/HSE dhe 9 punëtorë të kualifikuar e të përgjithshëm. Numri i përgjegjësve HSE dyfishohet, pasi punimet zhvillohen pranë gjurmës hekurudhore dhe në zonë me trafik të deviuar.

4. TRANZICIONI DHE REDUKTIMI (JAVA 6–8)

Në javën 6 fuqia zbritet lehtë në 38 persona: zejet strukturore reduktohen ndërsa hyjnë mjetet e mbushjes dhe kompaktimit (2 fadroma, 2 operatorë rul). Mbivendosja mure–mbushje mbahet e kontrolluar për të mos ngarkuar strukturën para arritjes së rezistencës së projektuar.

Java 7 (36 persona) karakterizohet nga zëvendësimi i ekipit strukturor me ekipin hekurudhor prej 8 punëtorësh të specializuar, plus dy operatorë vinçi për rivendosjen e traversave dhe binarëve, dhe shtresat rrugore.

Java 8 mbyllet me 30 persona: përfundimi i rivendosjes hekurudhore, asfaltimi, sistemimi përfundimtar, provat dhe kolaudimi. Ekipi drejtues, topografi dhe HSE mbahen deri në dorëzim.

5. LIDHJA E PIKUT ME GRAFIKUN GANTT

Piku i javës 5 nuk është rastësor: në Grafikun Gantt kjo është e vetmja javë ku faza 3 (Struktura e kutive BOX, java 3–5) dhe faza 4 (Muret hyrëse/dalëse, java 5–6) janë njëkohësisht aktive, dhe të dyja janë faza me përmbajtje të lartë pune manuale (kallëpe, armaturë, betonim).

Kurba e fuqisë punëtoare ndjek një profil klasik trapezoidal: mobilizim gradual javët 1–3, plato me intensitet të lartë javët 4–6, dhe reduktim i kontrolluar javët 7–8. Koeficienti pik/mesatare është rreth 1.3, vlerë që tregon një plan të balancuar pa luhajtje të mprehta që do të vështirësonin sigurimin e personelit.

Nuk ka asnjë javë ku personeli të jetë i mobilizuar pa aktivitet përkatës në Gantt: ekipi hekurudhor shfaqet vetëm në javët 1–2 (çmontim) dhe 7–8 (rivendosje), karpentierët dhe armaturistët vetëm gjatë javëve 3–6 (strukturë dhe mure), dhe operatorët e rulit vetëm në javët e ngjeshjes dhe të shtresave rrugore.


6. KUSHTE PËR REALIZIMIN E AFATIT 8-JAVOR

Afati i shkurtuar kërkon: turn të dytë të pjesshëm gjatë javëve 4–6, beton me forcim të shpejtë për të mundësuar heqjen e kallëpeve brenda 3–4 ditësh, furnizim të pandërprerë me betoniere dhe autopompë, si dhe koordinim paraprak me operatorin hekurudhor për dritaren e bllokimit të linjës në javët 1–2 dhe 7–8.

Numrat e mësipërm përfaqësojnë personelin mesatar ditor aktiv në kantier dhe nuk përfshijnë personelin e zyrës qendrore, fumitorët dhe laboratorin e provave.

GRAFIKU I FUQISË PUNËTORE – NDËRTIMI I NËNKALIMIT TË KANALIT TË NAUMKËS									
Programi i zbatimit – 8 javë									
Objekti: Nënkalim në rrugë dhe hekurudhë, Tombino BOX 2 copë 2.00 × 2.00 m, L = 17.00 m Hartoi: "DERBI-E" Shpk. — Ing. Bexhet DEDJA									
KATEGORIA E PERSONELIT	Java 1	Java 2	Java 3	Java 4	Java 5	Java 6	Java 7	Java 8	Gjithsej (person-javë)
A. PERSONEL DREJTUES, TEKNIK DHE MBIKËQYRËS									
Drejtuës kantieri / Inxhinier ndërtimi	1	1	1	2	2	2	2	1	12
Inxhinier / specialist hekurudhor	1	1	0	0	1	1	2	2	8
Topograf	1	1	1	1	1	1	1	1	8
Përgjegjës HSE / Siguri në punë	1	1	1	1	2	2	2	2	12
Teknik kantieri	1	1	1	2	2	2	1	1	11
Nëntotali — Personel drejtues, teknik dhe mbikë	5	5	4	6	8	8	8	7	51
B. OPERATORË MAKINERISH DHE TRANSPORT									
Operator eskavatori	1	2	1	0	1	1	1	1	8
Operator fadrome	1	1	1	1	1	2	1	1	9
Operator vinçi	0	0	1	1	1	1	2	1	7
Operator rul / kompaktor	0	1	1	0	0	2	2	2	8
Shoferë (kamionë, autobetoniere, autopompë)	2	3	3	3	4	4	4	3	26
Nëntotali — Operatorë makinerish dhe transport	4	7	7	5	7	10	10	8	58
C. ZEJE TË SPECIALIZUARA									
Karpentierë (kallëpe)	0	0	4	7	8	5	1	0	25
Hekurkthyes / armaturistë	0	2	4	6	6	3	0	0	21
Betonistë	0	0	3	4	5	3	2	2	19
Nëntotali — Zeje të specializuara	0	2	11	17	19	11	3	2	65
D. PUNËTORË									
Punëtorë për punime hekurudhore	4	3	0	0	0	0	8	6	21
Punëtorë të kualifikuar	2	2	3	3	4	4	3	3	24
Punëtorë të përgjithshëm	3	4	4	4	5	5	4	4	33
Nëntotali — Punëtorë	9	9	7	7	9	9	15	13	78
TOTALI I FUQISË PUNËTORE PËR ÇDO JAVË	18	23	29	35	43	38	36	30	252
Person-ditë për javë (6 ditë pune / javë)	108	138	174	210	258	228	216	180	1512
Fuqia kumulative (person-javë)	18	41	70	105	148	186	222	252	

TREGUESIT KRYESORË		
Fuqia punëtoe maksimale (piku)	43	punonjës
Java e pikut	Java 5	
Fuqia punëtoe mesatare javore	31.5	punonjës
Fuqia punëtoe minimale (mobilizim fillestar)	18	punonjës
Gjithsej person-javë	252	person-javë
Gjithsej person-ditë	1512	person-ditë
Koeficienti i pabarazisë (Pik / Mesatare)	1.37	



- BAZAE LLOGARITJES DHE SUPOZIMET**
- Aktivitetet dhe kohëzgjatjet janë marrë pa ndryshim nga Grafiku Gantt 8-javor i ngarkuar: Përgatitje/montim J1–2 · Gërimë J2–3 · Strukturë BOX J3–5 · Mure hyrëse/dalëse J5–6 · Mbushje/kompaktim J6–7 · Rivendosje hekurudhore J7–8
 - Volumet bazë (nga grafiku i punimeve): gërmim 428.65 m³ · beton C35/45 143.31 m³ · beton C30/37 21.14 m³ · armaturë 18.29 ton · hidroizolim 195.50 m² · waterstop 33.80 m · mbushje 88.03 m³ · shtresa rrugore 28.80 m³ · asfalt 16.00 m³
 - Normat e përdorura për dimensionimin e ekipeve: armaturist ~150 kg/ditë · karpentier ~12 m² kallëp/ditë · derdhje betoni me autopompë ~25–30 m³/ditë me ekip 5 vetësh · hidroizolim ~40 m²/ditë/person · gërmim me eskavator ~120 m³/ditë
 - Java e punës: 6 ditë × 8 orë. Për afatin e shkurtuar 8-javor supozohet turn i dytë i pjesshëm gjatë javëve 4–6 (strukturë BOX) dhe javëve 7–8 (bllokimi hekurudhor).
 - Personeli drejtues, topografi dhe HSE mbahen gjatë gjithë periudhës; HSE dyfishohet nga java 5 kur punimet zhvillohen paralelisht pranë gjurmës hekurudhore.
 - Qelizat me tekst blu janë të dhëna hyrëse (numri i personelit) dhe mund të ndryshohen; nëntoatlet, toalet dhe treguesit rillogariten automatikisht bashkë me grafikun.
 - Burimi: Grafiku Gantt 8-javor dhe Grafiku i punimeve të zbatimit, "DERBI-E" Shpk., Ing. Bexhet Dedja.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet te kete në dispozicion apo mund t’I vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike te nevojshme per ekzekutimin e kontrates, si me poshte (sipas formularit permbledhes te vetedeklarimit):

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
---------------	--------------	----------------

Nr	Emri i mjetit/pajisjes	Njesi	Sasia	Statusi
2	Eskavator me me zinxhire	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
3	Fadrom me goma me kove para mbrapa	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
4	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtës deri 20 ton	Copë	2	Ne pronesi ose me qera
7	Kamion me Vinc	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
9	Autobetoniere	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
10	Autopompe betoni	Copë	1	Ne pronesi ose me qera

Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier”, si më poshtë vijon:

- Kokore + Jelekë fosforoshentë minimumi 43 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 2 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 5 copë

❖ Kriteri konsiderohet i përmbushur me *plotësimin e Formularit përmbledhës të vetedeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8*. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin, si më poshtë:

- a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).
- b) Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: kontrata përkatëse e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme, dokumenti që verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, certifikatë për transport mallrash.
- c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.
- d) Per autobitumatricen te paraqitet certifikate per transport lendesh te rrezikshme
- e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- f) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas Deklaratës se shoqërisë ofertuese.

g) Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Shënim: Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin".

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK

***Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, bazuar në zërat e preventivit të punimeve.

- Mjetet e tjera që kërkohen i referohen sigurisë dhe shëndetit në kantier. Numri i kërkuar për secilin nga këto mjete i referohet numrit të personelit të kërkuar.

Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi/qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i'u referuar punimeve sipas standartave, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentat konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit.

Argumentimi i specifikimeve teknike : *Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistët e fushës, bashkëngjitur DST në SPE.*

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të

VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Të gjitha zërat e përshkruara në preventiv duhet të jenë sipas specifikimeve teknike. Në rast se në një nga zërat e preventivit është shkruar me emra marke automatikisht do të pranohet edhe një produkt ekuivalent.